



Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



This project is financed by  
the European Union



BALKAN  
CIVIL  
SOCETY  
DEVELOPMENT  
NETWORK



Sida

# LLOGARIDHËNIA në

# ARSIM

Monitorimi i Parimeve të RAP në Sektorët e Politikave -  
Raporti për Shqipërinë

Publikimi:  
**Llogaridhënia në sektorin e arsimit**

Publikuesi:  
**Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim – IDM**

Autore:  
**Gladiola Lleshi, Qëndresa Qytetare**

Grafika:  
**Eduart Cani**

Tiranë, korrik 2022

**FUSHA RAP: LLOGARIDHËNIA**  
**SEKTORI I POLITIKAVE: ARSIMI**  
**INSTITUCIONI: MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**



Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe SIDA-së përmes Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile. Përgjegjësia për përmbajtjen dhe informacionin e këtij publikimi i përket vetëm autores, publikuesit dhe rrjetit Think for Europe. Opinionet e shprehura në këtë publikim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian, SIDA-së apo Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile. Për më shumë informacion, luteni të shkoni në: [www.par-monitor.org](http://www.par-monitor.org)



This project is financed by the European Union



institut alternativa



# PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJE E RAPORTIT</b>	<b>4</b>
<b>I. HYRJE</b>	<b>5</b>
<b>I.1 Çfarë monitoron WeBER-i dhe përse?</b>	<b>5</b>
<b>I.2 Në këtë raport</b>	<b>5</b>
<b>II. ANALIZA</b>	<b>6</b>
<b>III. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM</b>	<b>11</b>
<b>SHTOJCAT</b>	<b>12</b>
<b>Akresi falas i kërkesave të informacionit</b>	<b>12</b>
<b>Burime të tjera</b>	<b>12</b>

# PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

E drejta e informimit mundëson transparencë dhe kontribuon për shqyrtimin e veprimtarisë së qeverisë si dhe për forcimin e proceseve demokratike të vendimmarrjes. E drejta e informimit fuqizon qytetarët dhe u jep atyre mjetet dhe njohuritë e nevojshme për të marrë pjesë në jetën publike si dhe të angazhohen me organizata publike.<sup>1</sup>

E drejta e informimit është sanksionuar nga Kushtetuta e Shqipërisë dhe garantohet me ligj. Në këtë raport, aksesit në informacion u vlerësua në sektorin e politikave të arsimit në kuadrin e zonës së llogaridhënies të RAP. Institucioni që iu nënshtrua monitorimit është Ministria e Arsimit dhe Sportit (në vijim MAS), ku u identifikuan trende, problematika dhe rekomandime të caktuara.

Raporti i monitorimit bazohet në periudhën një-vjeçare shkurt 2021 - shkurt 2022. Pas një liste kontrolli që identifikon 7 kërkesat e vlerësuara, ky raport ofron një vështrim të thellë mbi gjendjen e së drejtës së informimit në sektorin e politikave të arsimit.

Gjatë raportit të monitorimit, MAS-i mori 210 Kërkesa për Informacion (në vijim KI). Është pozitive që pjesa më e madhe e kërkesave KI trajtohen në pajtim me afatet dhe pala e interesuar merr përgjigje brenda 10 ditësh pune nga dita e dorëzimit. Vlen të përmendet se për të vlerësuar suksesin e të drejtës për ofrimin e informimit është e domosdoshme që përgjigjet e dhëna të vlerësohen sipas përmbajtjes së tyre.

Si rrjedhojë, gjatë periudhës së monitoruar u vlerësuan 3 kërkesa dhe përgjigje KI. Për të pasur një kampion me shumëllojshmëri, përzgjidhen kërkesa me karakteristika të ndryshme. U gjet se për 2 nga 3 të këtyre kërkesave KI, informacioni i ofruar nuk i trajtonte tërësisht kërkesat e dorëzuara. Si rrjedhojë, kjo tregon se pavarësisht se në pamje të jashtme përmbushen kushtet ligjore, kërkesat nuk u trajtuan plotësisht dhe morën përgjigje të kufizuara.

Për më tepër, legjislacioni kombëtar parashikon rastet kur mund të paguhet një tarifë për dorëzimin e një kërkesë KI. Është pozitiv fakti që nuk u paguan tarifa për asnjë nga 210 kërkesat KI të dorëzuara për raportin e monitorimit. Kjo e konsolidon këtë të drejtë dhe e lehtëson procesin e kërkimit të informacionit si dhe mundëson që çdo palë e interesuar të dorëzojë kërkesën përkatëse pavarësisht mjeteve të tyre financiare.

Aksesi në informacion përfshin një shumëllojshmëri aspektesh që duhen marrë parasysh. Faqet zyrtare të internetit të institucioneve luajnë rol thelbësor për informimin e qytetarëve në fushën përkatëse si dhe për trajtimin e pyetjeve të qytetarëve. Si rrjedhojë, një faqe interneti e përditësuar dhe e pasuruar kontribuon për informimin e qytetarëve në mënyrë të shpejtë dhe efikase. Gjatë shqyrtimit dhe analizimit të përmbajtjes së faqes së internetit të MAS u identifikuan disa problematika. Edhe pse detajet e kontaktit të Koordinatorit për sete Drejtën e Informimit janë të disponueshme, nuk mund të gjenden lehtësisht. Veç kësaj, faqja e internetit e ministrisë nuk ia ka dalë të integrojë seksionin e pyetjeve të shpeshta dhe informacioni i disponueshëm është i kufizuar sikurse vërehet nga mungesa e dokumenteve të politikave, raporteve vjetore dhe detajeve të vlefshme të kontaktit. Për sa i përket informacionit të publikuar nga institucioni, vërehet se dokumentet janë të lehta për t'u përdorur; megjithatë, ato mbeten shumë të kufizuara lidhur me sasinë e të dhënave dhe informacionit të publikuar nga institucioni. Për më tepër, kjo i shtohet gjetjes se informacioni publik nuk ofrohet në mënyrë proaktive.

Çështjet e përmendura më sipër mund ta pengojnë këtë të drejtë, si dhe të shkaktojnë shpenzime të mëtejshme dhe të konsumojnë kohën e institucionit. Në përgjithësi, rezultatet e monitorimit shfaqin dhe nxjerrin në pah një sërë problematikash që duhet të trajtohen. Pavarësisht rezultateve pozitive të dukshme të gjeneruara në disa aspekte të përmendura gjatë këtij seksioni, çështjet thelbësore të identifikuar prekin llogaridhënien e MAS-it.



<sup>1</sup> <https://uncaccoalition.org/learn-more/access-to-information/>

# I. HYRJE

## I.1 Çfarë monitoron WeBER-i dhe përse?

Monitorimi i Zonës së Llogaridhënies (ACC) kryhet kundrejt Parimit SIGMA 2.

***Parimi 2: E drejta për të aksesuar informacionin publik është miratuar në legjislacion dhe aplikohet vazhdimisht në praktikë.***

Lista e kontrollit e ACC-së konsiston në 7 kërkesa që i përkasin praktikës së (bazuar te akses i lirë në kërkesat për informacion) ofrimit reaktiv dhe proaktiv të informacionit. Në fushën e informimit reaktiv, kërkesat marrin në konsideratë nëse institucioni i vlerësuar përmbush afatet ligjore kur u përgjigjet kërkesave për akses të lirë në informacion, nëse përmbajtja e këtyre përgjigjeve korrespondon me atë është kërkuar (bazuar në kampion) dhe nëse institucioni i vlerësuar ofron zakonisht përgjigje falas. Së fundi, vlerësohet nëse institucioni publikon një seksion të aksesueshëm online me pyetje të shpeshta që ofron udhëzime të kuptueshme nga qytetarët ose ndihmë për ushtrimin e kësaj të drejte.

Në fushën e informimit proaktiv, vlerësohet nëse institucioni përgjegjës i bën lehtësisht të aksesueshme online informacionet për personin(at) e kontaktit për një KI dhe nëse të gjitha informacionet bazë nga puna e institucionit janë të disponueshme për shqyrtimin e publikut, përfshirë këtu politikat dhe aktet ligjore, shërbimet publike të ofruara, raportet vjetore, buxhetin, kontratat e përgjithshme dhe grafikët organizues. Së fundmi vlerësohet nëse ekzistojnë praktikatat e mundësimit proaktiv në formate të hapura, si dhe sa rregullisht publikohen të dhënat e hapura.

Për të monitoruar dhe vlerësuar se sa arrihet akses i lirë në informacion, janë paraqitur kërkesa për lirinë e informacionit për të gjitha dokumentet që nuk janë të disponueshme online, por edhe për të vlerësuar praktikatat e institucionit përgjegjës për dhënien e përgjigjeve ndaj kërkesave. Për më tepër, qasja metodologjike e kësaj liste kontrolli mbështetet te rishikimi i faqeve të internetit të institucioneve të vlerësuara dhe portaleve me të dhëna të hapura të sponsorizuara nga qeveria. Në varësi të kërkesave individuale, periudha kohore e analizës mbulon ose praktikatat aktuale që ekzistojnë në momentin e vlerësimit, ose periudhën 12-mujore të zhvillimit të vlerësimit.

## I.2 Në këtë raport

Ky raport është i ndarë në dy pjesë kryesore. Pjesa e parë është analiza e hartuar sipas parimit SIGMA 2 të monitorimit të llogaridhënies në RAP për Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve. Llogaridhënia është një nga fushat bazë të RAP-it, e domosdoshme për zhvillimin e reformave të nevojshme strukturore.

Struktura e analizës bazohet te vlerësimi i 7 kërkesave që vlerësojnë efektshmërinë dhe efikasitetin e së drejtës për informim nëpërmjet kërkesave KI. Për më tepër, këto kërkesa vlerësojnë ofrimin e informacionit për publikun nëpërmjet mjeteve të tjera të informacionit, si faqet zyrtare të qeverisë. Prandaj, kërkesat e vazhdueshme synojnë të ofrojnë një vështrim të përgjithshëm të aksesit në informacion, në përgjithësi për sektorin e politikave për arsimin. Kjo lehtëson vlerësimin përfundimtar, duke shënuar nëse kërkesat e zonës RAP janë përmbushur plotësisht, pjesërisht ose nuk janë përmbushur aspak.

Për më tepër, bazuar te gjetjet nga vlerësimi i 7 kërkesave të tjera, pjesa e dytë e këtij raporti përqendrohet te rekomandimet që fokusohen në çështje të caktuara të identifikuara dhe japin zgjidhje konkrete brenda periudhash të caktuara kohore.

## II. ANALIZA

### *Kërkesa 1: Institucioni përgjegjës e dorëzon informacionin në afatin e përcaktuar*

Neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garanton të drejtën për informim, duke deklaruar se “E drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.”

Numri total i kërkesave KI i dorëzuar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për periudhën shkurt 2021 - shkurt 2022 ishte 210. Vlen të përmendet se 33 (15.7%) prej kërkesave KI të dorëzuara nuk morën përgjigje brenda 10 ditësh pune siç sanksionohet në legjislacionin kombëtar dhe, si rrjedhojë, nuk përmbushën kërkesat ligjore lidhur me këtë. Ky vlerësim është në përputhje me **nenin 15, seksioni 1** i ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” që deklaron se “Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.”<sup>2</sup>

Për më tepër, vërehet se për 5 (2.4%) nga kërkesat KI të dorëzuara mungonte informacioni në lidhje me ditën e përgjigjes për kërkesën, përgjigjen e ofruar dhe nëse kërkesa KI ishte trajtuar plotësisht, pjesërisht apo u ishte deleguar institucioneve të tjera të përshtatshme.

Duke pasur parasysh këtë, për pjesën e mbetur të 205 kërkesave u theksua se 7 (3.3%) kërkesa KI kishin marrë përgjigje të kufizuara, 2 (1%) kërkesa kishin marrë përgjigje të pjesshme, 1 (0.4%) kërkesë ishte refuzuar mbi bazën që nuk ishte në përputhje me ligjin dhe 19 (9%) kërkesa të tjera u qenë deleguar institucioneve të tjera të përshtatshme.

Përgjigje KI të refuzuara - 0.4%

Përgjigje KI të pjesshme - 1%

E panjohur - 2.4%

Përgjigje KI të kufizuara - 3.3%

Përgjigje KI të deleguara - 9%

Përgjigje KI të plota - 83.9%

Për më tepër, 3 (1.4%) kërkesa KI të dorëzuara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve për periudhën shkurt 2021 - shkurt 2022 ishin me gabime. Në të tri kërkesat KI, data e përgjigjes ishte në një datë më të hershme se sa data e kërkesës së dorëzuar.

Kërkesat KI që shfaqën gabime - 1.4%

Kërkesat KI të cilave u mungonte informacioni - 2.4%

Kërkesat KI që nuk e përmbushnin afatin ligjor - 15.7%

Kërkesat KI që përmbushnin afatet ligjore - 80.5%



2 [https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Ligj\\_119\\_2014\\_18.09.2014.pdf](https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Ligj_119_2014_18.09.2014.pdf)

U vërejt një tendencë e përgjithshme për t'iu përgjigjur kërkesave KI në fund të afatit ligjor, në veçanti atyre kërkesave që konsideroheshin më kërkuese. Prilli u identifikua si muaji me përgjigjet më të shpejta në krahasim me dhjetorin që u identifikua si muaji me më shumë përgjigje KI në skajet e afatit ligjor.

## *Kërkesa 2: Institucioni përgjegjës dorëzon informacionin e kërkuar*

Për qëllimin e këtij raporti, janë zgjedhur dhe analizuar 3 kërkesat KI që janë konsideruar si më kërkueset gjatë periudhës së vlerësimit shkurt 2021 - shkurt 2022.

Kërkesa KI nr.156 e periudhës së vlerësimit kërkonte numrin e nxënësve Romë dhe Egjiptianë në nivel kombëtar dhe numrin e përgjithshëm të nxënësve të regjistruar në institucionet private dhe publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2020-2021. Përgjigja sugjeronte se MAS-i nuk zotëron të dhëna mbi numrin e nxënësve Romë dhe Egjiptianë dhe si rrjedhojë është dhënë një përgjigje e kufizuar që deklaron vetëm numrin e përgjithshëm të nxënësve në institucionet e arsimit të lartë.

Kërkesa KI nr. 83 e periudhës së vlerësuar detajon informacionin për klasat digjitale në nivel kombëtar. U vërejt se 2 nga 4 pyetjet në kërkesë nuk ishin trajtuar. Për sa i takon pyetjes mbi funksionalitetin e klasave digjitale, përgjigja përcaktoi vetëm numrin e klasave digjitale dhe nuk dha asnjë informacion të mëtejshëm. Për më tepër, pyetja për buxhetin e shpenzuar për projektin e klasave digjitale nga viti 2015 e më tej nuk ishte trajtuar.

Kërkesa KI nr. 84 e periudhës së vlerësuar kërkoi informacion të detajuar për shërbimin psikologjik dhe të sigurisë në shkolla. Ia vlen të përmendet që përgjigja e dhënë ishte e kënaqshme dhe i trajtoi të gjitha pyetjet e renditura në kërkesë.

Në përgjithësi, në dy nga tre çështjet e përzgjedhura, përgjigja e dhënë nuk ishte e kënaqshme sepse nuk dha informacion të mjaftueshëm për pyetjet e shtruara. Çështjet e përzgjedhura ishin të ndryshme sipas objektit të kërkesës KI, pavarësisht llojit të përgjigjes së kthyer nga institucioni dhe nëse ishin zbatuar afatet ligjore për kthimin e përgjigjes apo jo. Prandaj, kjo shërben si një mostër ilustrimi që pavarësisht faktit se MAS iu përgjigj këtyre pyetjeve, janë identifikuar probleme me përmbajtjen e këtyre përgjigjeve të dhëna.

## *Kërkesa 3: Institucioni përgjegjës, si rregull, nuk tarifon për dhënien e përgjigjeve ndaj Kërkesave për Informacion*

**Neni 13 seksioni 1** i ligjit nr. 119/2014 "Mbi të drejtën e informimit" deklaron se shërbimet e administratës publike janë pa pagesë. Dhënia e informacionit mund të bëhet kundrejt një tarife të përcaktuar më parë dhe të bërë publike nga autoriteti publik në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut. Tarifa është kostoja e riprodhimit të informacionit të kërkuar dhe, sipas rastit, e dërgimit të tij. Informacioni i kërkuar në mënyrë elektronike jepet pa tarifë.

Për më tepër, **Neni 13 seksioni 2** deklaron se kostoja e riprodhimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja reale e materialit, mbi të cilin riprodhohet informacioni. Kostoja e dërgimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja mesatare e të njëjtit shërbim në treg.

Faqja e internetit e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nuk paraqet listë çmimesh për t'iu dhënë përgjigje kërkesave KI në rastet e riprodhimit të informacionit të kërkuar dhe/ose dërgimit sikurse parashikohet nga ligji. Për më tepër, këto lista çmimesh nuk shfaqen në mjediset publike të pritjes të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Brenda kuadrit të këtij raporti, një kërkesë KI iu dërgua Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, duke kërkuar numrin e KI-ve të dorëzuara tek MAS-i për periudhën shkurt 2021- shkurt 2022. Kërkesa u dorëzua në 29 prill 2022 dhe përgjigja u mor më 12 maj 2022 (e enjte), pra, afati ligjor i marrjes së një përgjigjeje nga ky institucion u zbatua.

Për më tepër, ky regjistër jep informacion nëse u administrua ndonjë tarifë gjatë ofrimit të këtij informacioni të kërkuar apo jo. Vihet re se nuk u administrua asnjë tarifë për asnjë nga 210 KI-të e dorëzuara gjatë periudhës së monitoruar. KI-ja e dorëzuar për qëllimin e këtij raporti shërben si provë e praktikës së ngulitur për të mos paguar asnjë tarifë për informacionin e kërkuar nga cilado palë e interesuar.

***Kërkesa 4: Institucioni përgjegjës publikon në internet një seksion pyetjesh të shpeshta, të aksesueshëm, të dobishëm dhe të lehtë për t'u përdorur për qytetarët, për aksesin e lirë në informacionet për publikun.***

Seksioni i pyetjeve të shpeshta është një pjesë integrale e të ndihmuarit të qytetarëve dhe drejtimit të tyre drejt zgjidhjes së shpejtë të pyetjeve të tyre. Për më tepër, i pengon qytetarët t'i bëjnë pyetje të mëtejshme institucionit për çështje që mund të trajtohen në këtë seksion të faqes së Internetit.

Faqja e Internetit e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nuk ka një seksion për pyetjet e shpeshta që mund të aksesohet lehtësisht për pyetje të tilla. Është detyra e institucionit t'i përzgjedhë pyetjet e bëra më shpesh dhe t'i paraqesë ato në faqen e Internetit për lehtësimin e lundrimit në faqen e internetit nga qytetarët dhe trajtimin e pyetjeve në mënyrë të shpejtë dhe efkase.

***Kërkesa 5: Institucioni përgjegjës mundëson informacion të aksesueshëm lehtësisht për personin e kontaktit, për Kërkesat për Informacion.***

Ministria e Arsimit dhe Sportit shfaq në faqen kryesore një numër programesh, ndër të cilët - programi i transparencës. Programi paraqitet nëpërmjet një grafiku ku identifikohet lehtësisht "e drejta e informimit dhe ankimit". Në këtë seksion mund të gjenden detajet e kontaktit të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, emri, mbiemri dhe adresa e tij/saj e e-mail-it.

Klikimi dhe kërkimi përmes gjithë faqes së internetit për të gjetur këtë kontakt në fund të një liste të gjatë programesh të ndërmarra nga MAS-i, që shfaqen në faqen kryesore, ka vështirësitë e veta. Edhe pse duhen vetëm tri klikime për të gjetur detajet e kontaktit, ato nuk mund të gjenden lehtësisht dhe nuk ka asnjë tregues në faqe që mund t'i drejtojë qytetarët në seksionin ku mund të gjendet ky kontakt. Për më tepër, te faqja kryesore e MAS-it ka një listë shteruese të kontakteve e cila mund të aksesohet lehtësisht. Megjithatë, detajet e kontaktit të koordinatorit të KI nuk përfshihen aty.

Në përputhje me **Nenin 10 të Ligjit nr.119/2012**, "Mbi të drejtën e informimit", Autoriteti Publik emëron një nga zyrtarët Koordinator për të drejtën e informimit që të koordinojë punën për të garantuar të drejtën e informimit.<sup>3</sup> Ky ligj parashikon kompetencat e koordinatorit dhe përvijon detyrat e tij administrative. Për më tepër, **Akti i Rregullores së Brendshme të MAS-it, në Nenin 34**, deklaron detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit KI të emëruar në ministri.<sup>4</sup>



3 <https://www.idp.al/koordinator-per-te-drejte-e-informimit-2/>

4 [https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Rregullore\\_e\\_e\\_brendshme\\_e\\_MAS\\_20171.pdf](https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Rregullore_e_e_brendshme_e_MAS_20171.pdf)



## *Kërkesa 6: Institucioni përgjegjës publikon në mënyrë proaktive në internet informacionin bazë publik për punën e tyre.*

Faqja e Internetit e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit paraqet aktet ligjore parësore dhe sekondare nën fushëveprimin e institucionit sektorial. Këto akte mund të aksesohen lehtësisht te faqja kryesore e institucionit, te seksioni i lajmeve.

Megjithatë, vihet re që ka mungesë dokumentesh të politikave të publikuara në internet. Në këtë mënyrë, politikat në lidhje me arsimin të cilat i japin formë punës së MAS-it mbeten të paqarta.

Lista e shërbimeve publike të ofruara mund të gjendet te faqja kryesore e MAS-it, te sektori i Ministrisë. Lista përfshin një shumëllojshmëri shërbimesh publike që u ofron MAS-i qytetarëve, për të cilat jepen udhëzime, lista e dokumenteve, procedura dhe standardi normativ që duhet përmbushur për të marrë këto shërbime.

Për më tepër, MAS-i nuk paraqet asnjë raport vjetor të punës së tij. Në vend të kësaj, në seksionin 'Lajme' të faqes kryesore, thuhet se gjendet një raport i cili daton në korrik 2014. Gjithsesi, kur klikohet raporti, rezulton vetëm deklarata e ish-Ministres së Arsimit dhe Sportit për këtë raport dhe jo vetë raporti.

Plani i buxhetit për vitin në vazhdim mund të gjendet në faqen kryesore të faqes së internetit të MAS-it, te seksioni i Ministrisë, nënseksioni i Buxhetit dhe Financës. Për më tepër, ekzekutimi i buxhetit për vitin e mëparshëm mund të gjendet brenda të njëjtit nën-seksion me raportet e monitorimit dhe dokumentet ku detajohen shpenzimet.

Për sa i takon informacionit të përgjithshëm të kontaktit për Strukturën Organizative publike, mund të gjendet në faqen kryesore të MAS-it, te seksioni i Ministrisë. Gjithsesi, ky grafik nuk është publikuar në një skedar të veçantë. Për sa i takon emrave të zyrtarëve kryesorë (ministrave, zëvendësve të tyre, asistentëve, dhe sekretarëve të përgjithshëm/të shtetit), ata nuk janë të integruar në strukturën organizative, por në një seksion të veçantë. Lista e kontakteve përfshin kontaktin e Ministres dhe të drejtorëve të emëruar të drejtorive dhe institucioneve nën Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Gjithsesi, vlen të theksohet që detajet e kontaktit të Ministres së Arsimit dhe Sportit nuk janë të disponueshme nën atë seksion të veçantë.

## *Kërkesa 7: Institucioni përgjegjës publikon të dhënat në formate të hapura*

Të dhënat e hapura janë në thelb publikimi i të dhënave dhe informacionit në një format i cili mund të përdoret, modifikohet dhe shpërndahet lirisht nga çdo palë e interesuar. Ky koncept e ka zanafillën te ideja që informacioni i mbledhur nga qeveria duhet të jetë i disponueshëm për qytetarët.<sup>5</sup>

Në lidhje me qasjen e qeverisë shqiptare ndaj të dhënave të hapura, zhvillimet janë shumë të reja. Në vitin 2015, Këshilli i Ministrave kaloi Vendimin nr.147 "Për miratimin e dokumentit të politikave për implementimin e të dhënave të hapura publike dhe krijimin e portalit të të dhënave të hapura".<sup>6</sup>

Gjatë kohëve të fundit, u miratua dhe u shtua në legjislacionin kombëtar ligji nr.33/2022 "Mbi të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik", duke pasur si qëllim nxitjen e përdorimit të të dhënave të hapura në Republikën e Shqipërisë. **Neni 6 seksioni 15** i këtij ligji i përkufizon të dhënat e hapura si "Një format i pavarur nga platforma, i disponueshëm për publikun pa kufizime që ndalojnë ripërdorimin e dokumenteve, duke treguar me detaje detyrimin ligjor të institucioneve të sektorit publik për t'i bërë të disponueshme të dhënat në një format të hapur".<sup>7</sup>

5 <http://opendatatoolkit.worldbank.org/en/open-data-in-60-seconds.html>

6 <https://rm.coe.int/handbook-albania-eng/1680903022>

7 <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20220406123507ligj%20nr.%2033%20dt.%2031.3.2022.pdf>

Për më tepër, **Neni 7 seksioni 3** i ligjit nr.33/2022 deklaron që “Organi i sektorit publik vendos listën e dokumenteve ekzistuese që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura dhe e bën të disponueshëm për publikun”. Theksohet se Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk siguron një listë për dokumentet e të dhënave të hapura që përfshihen në objektivin e Ministrisë.

MAS-i ofron sete të dhënash në një format miqësor ndaj përdoruesit në faqen zyrtare të internetit, të cilat janë kryesisht akte ligjore, të dhëna për buxhetin, të dhëna për programet e zbatuara nga ministria dhe regjistrat e kërkesave dhe përgjigjeve KI. Gjithsesi, MAS-i nuk siguron setet e përditësuara të të dhënave dhe raportet vjetore që përfshijnë objektin dhe fushën e veprimit të ministrisë. Pra, institucioni nuk është proaktiv lidhur me sigurimin e të dhënave të plota, të qarta dhe thelbësore për qytetarët që t’u japin mundësinë atyre dhe çdo pale të interesuar që t’u kërkojnë institucioneve llogari.

### Vlerësimi përfundimtar i kërkesave

Kërkesa	Vlerësimi Përfundimtar
Kërkesa 1: Institucioni përgjegjës e jep informacionin brenda afatit të përcaktuar	Përbushur plotësisht
Kërkesa 2: Institucioni përgjegjës jep informacionin e kërkuar	Papërbushur
Kërkesa 3: Institucioni përgjegjës, si rregull, nuk tarifton për dhënien e përgjigjeve ndaj kërkesave për informacion.	Përbushur plotësisht
Kërkesa 4: Institucioni përgjegjës publikon në internet një seksion pyetjesh të shpeshta, të aksesueshëm, të dobishëm dhe të lehtë për t’u përdorur për qytetarët, për aksesin e lirë në informacionet për publikun.	E papërbushur
Kërkesa 5: Institucioni përgjegjës mundëson informacion të aksesueshëm lehtësisht për personin e kontaktit, për Kërkesat për Informacion.	Përbushur pjesërisht
Kërkesa 6: Institucioni përgjegjës publikon në mënyrë proaktive në Internet informacionin bazë publik për punën e tyre.	E papërbushur
Kërkesa 7: Institucioni përgjegjës publikon të dhënat në formate të hapura.	Përbushur pjesërisht

### III. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM

- IV.** Duke marrë në konsideratë gabimet e identifikuara në regjistrat publikë të KI-ve, Ministria duhet të garantojë publikimin e regjistrave me saktësi dhe pa gabime. Kjo kërkon një ndërhyrje afatshkurtër për të korrigjuar gabimet dhe pasaktësitë e vëna re si dhe shtimin e angazhimit të institucionit për të siguruar të dhëna të sakta.
- V.** Vihet në dukje se MAS-i, në përgjithësi, priret t'u kthejë përgjigje KI-ve brenda afateve të kërkuara ligjore; megjithatë, institucioni duhet të garantojë që këto kërkesa të marrin përgjigje plotësisht dhe në mënyrë substanciale dhe jo në mënyrë selektive apo sipas vlerësimit. Kjo ka nevojë për një ndërhyrje afatgjatë nga institucioni, që qytetarëve dhe çdo pale të interesuar t'u ofrohet informacion i saktë që i trajton kërkesat e tyre plotësisht.
- VI.** MAS-i duhet të veprojë sipas ligjit dhe të publikojë tarifat e administruara në rastet e KI, si në faqen e internetit, ashtu edhe në mjediset pritëse të institucionit. Kjo kërkon një ndërhyrje afatshkurtër nga institucioni që të publikohet informacioni për tarifat.
- VII.** Duke pasur parasysh që faqja e Internetit e MAS-it nuk ka një seksion për pyetjet e shpeshta, është e domosdoshme që Ministria të përfshijë një seksion pyetjesh të shpeshta që të jetë i aksesueshëm, i dobishëm dhe i lehtë për t'u përdorur nga qytetarët, pasi kështu do të trajtonte pyetjet e qytetarëve dhe të çdo pale të interesuar në mënyrë të shpejtë dhe efikase, si dhe do të forconte të drejtën për akses në informacion. Kjo kërkon ndërhyrje afatmesme nga institucioni për të arritur përpilimin e një liste pyetjesh dhe përgjigjesh dhe për t'i bërë ato të disponueshme për publikun.
- VIII.** MAS-i duhet të sigurojë që detajet e kontaktit e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit të jenë të lehta për t'u gjetur dhe të listuara në seksionin e kontaktit të faqes kryesore të faqes së internetit. Kjo kërkon ndërhyrje afatmesme për të riorganizuar faqen e Internetit duke bërë prioritet aksesin më të lehtë në informacion dhe detajet e kontaktit të zyrtarëve publikë.
- IX.** MAS-i duhet të publikojë informacione bazë në Internet për punën e tij duke përfshirë dokumentet e politikave dhe raportet vjetore. Duke marrë parasysh që kjo është një punë në vazhdim, kërkon ndërhyrje afatgjatë dhe angazhim nga institucioni për të publikuar të dhënat dhe informacionin më thelbësor në lidhje me punën që merr përsipër ministria.
- X.** Pavarësisht faktit se faqja e Internetit e MAS-it paraqet një seksion që përmban detajet e kontaktit të zyrtarëve publikë, në shumë raste këto kontakte janë të pasakta ose nuk shfaqen fare. Institucioni duhet të sigurojë saktësinë e këtyre detajeve të kontaktit nëpërmjet një ndërhyrjeje afatshkurtër që t'i trajtojë këto pasaktësi.
- XI.** MAS-i duhet të sigurojë setet e përditësuara të të dhënave dhe raportet vjetore që përfshijnë objektin dhe fushën e punës ku operon ministria. Kjo kërkon ndërhyrje me afat kohor të gjatë dhe angazhim nga ana e institucionit kundrejt publikimit të të dhënave dhe informacionit në një format i cili mund të përdoret, modifikohet dhe shpërndahet me lehtësi nga secila palë e interesuar.

# SHTOJCAT

## Aksesi falas i kërkesave të informacionit

Institucioni	Data e dërgimit	Data e marrjes
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT	29 prill 2022 (E premte)	12 maj 2022 (e enjte)
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT	19 maj 2022 (e enjte)	27 maj 2022 (e premte)

## Burime të tjera

1. Faqja zyrtare e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, 2022
2. Regjistri dhe Formatit i Kërkesave për Informacion, faqja zyrtare e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, 2022
3. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 2022
4. Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", 2014
5. Rregullorja e brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, 2017
6. Shehaj, A., 2018. Liria e Informimit dhe Perceptimi i Qytetarëve në Shqipëri. [online] ResearchGate. <[https://www.researchgate.net/publication/330991731\\_Freedom\\_of\\_Information\\_and\\_Citizens%27\\_Perception\\_in\\_Albania](https://www.researchgate.net/publication/330991731_Freedom_of_Information_and_Citizens%27_Perception_in_Albania)>
7. Idp.al. 2022. Koordinator për të drejtën e informimit | IDP. [online] <<https://www.idp.al/koordinator-per-te-drejte-e-informimit-2/>>
8. Këshilli i Evropës, 2018. [online] Rm.coe.int. <<https://rm.coe.int/handbook-albania-eng/1680903022>>
9. Ligji nr. 33/2022 "Mbi të dhënat e hapura dhe përdorimin e informacionit të sektorit publik", 2022
10. Koalicioni KKBKK. 2022. Aksesi në informacion | Koalicioni KKBKK [online] <<https://uncaccoalition.org/learn-more/access-to-information/>>